



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 32/21

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. - Blerim Dina- Referues, z. Goran Milenković – Anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: OE “Aritech” Sh.P.K - Graçanicë, kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë operatorët ekonomik: “Panamic ICT” L.L.C-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Kompjuter dhe Laptop”, Lot 2, me nr. të prokurimit: 632-20-4552-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “KK Gjakovë”, më datën: 25.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Aritech” Sh.P.K - Graçanicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Kompjuter dhe Laptop”, Lot 2, me nr. të prokurimit: 632-20-4552-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “KK Gjakovë”.

II. ANULOHET, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Kompjuter dhe Laptop”, Lot 2, me nr. të prokurimit: 632-20-4552-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – “KK Gjakovë”, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Aritech” Sh.P.K - Graçanicë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

cilat ju përshtaten me disa tabela ekzistuese që do të thotë madhësia e TV nuk guxon të jetë me e madhe siç është para parë andaj nuk mund të pranohet TV me specifika të OE ankues. “Duke marrë për bazë kërkesat e dosjes së tenderit dhe pajisjen e ofertuar nga OE ankues është e qartë se pajisja e ofertuar përmbushë qëllimin dhe specifikimet dhe i tejkalon në kuptimin e madhësisë së ekranit si element që ndikon edhe në çmimin e këtij produkti. Më tej arsyetimi i AK-së nuk është shumë bindës duke marrë për bazë se nuk ka prezantuar asnjë dëshmi konkrete të ndonjë lokacioni ku mund të vendoset TV 54.6” dhe nuk mund të vendoset TV 58”. Po ashtu në rastet kur TV vendoset në mure, panelet e vendosjes janë standarde dhe përfshijnë dimensione që variojnë, shembull nga 50” deri 60”. Andaj, sipas sqarimeve të mësipërme, pretendimi ankimor është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e sipërpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues “Aritech” Sh.P.K të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe rekomandon që lënda (Lot 2) të kthehet në **rivlerësim**.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 20.01.2021, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 20.01.2021, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.02.2021, përmes platformës zoom e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Kryetari i panelit hapi seancën e shqyrtimit kryesorë të ankesës të mbajtur në ZOMM në ora 11:30 ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesit e OE-së ankues, përfaqësuesit AK-së, eksperti shqyrtues, Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me përbërjen e panelit, dhe pasi konstatoi se nga të pranishmit nuk pati vërejtje në këtë përbërje, vazhdoi me seancën.

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me objektin e shqyrtimit si dhe me shkresat e lëndës dhe në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të OE-së ankues i cili deklaroi : Ashtu siç ka konfirmuar edhe eksperti shqyrtues AK nuk ka qen bindes në lidhje me arsyetimin e tij për eliminim me kompanisë tone rreth madhësisë për

smart TV e cila nuk mund të jetë me e madhe sesa 54.6 inq, përveç kësaj me lart në nuk kemi pranuar asnjë përgjigje nga AK në lidhje me kërkesën tone për qasje në shkollat për të cilat pretendohet që smart TV duhet të kenë madhësinë fikse në besojmë se smart TV 58 inq që kemi ofertuar në nuk duhet të refuzohet sepse është me mirë sesa kërkesa për madhësinë 54.6 inq përderisa plotësohen të gjitha kërkesat teknike të tjera . për fud kërkesa jon për panelin shqyrtues është që lënda të rikthehet në rivlerësim dhe AK të shpërblej me kontrata kompaninë e cila plotëson të gjitha kërkesat dhe është e përgjegjshme në këtë projekt tenderues.

Në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të AK-së i cili deklaroj: në si AK i qëndrojmë prapa vendimit që kemi shpall për arsye se ashtu siç e kemi cekur në të gjitha shkollat ... dhe janë disa pika ku nuk përshtatet fiks ekrani dhe për atë arsye e kemi jap atë përgjigje dmth fiks duhet me qen 54.6 inq ekrani krejt në fund me datën 27.01 kemi kërkuar vlefshmërinë e tenderit dhe sigurinë nga OE pra dhe kompania aritech ka sjell vetëm vlefshmërinë dhe jo edhe sigurimin tenderit . të mbetet në fuqi vendimi i komunës dhe të refuzohet ankesa .

Në fjalën përfundimtare Eksperti deklaroj : Qëndroj pran raportit të ekspertizës të datës të dorëzuar tek palët arsyetja e eliminimit ka qen se ofertuesi Aritech ka ofertu me ekran 58 inq ndërsa kërkesa në dosje të tenderit ka qen 54.6 me tej AK nuk ka jep asnjë arsyetim bindës apo dëshmi mbi bazën e të cilës mund të konstatohet se me cilën dimension ekrani nuk mund të jetë me i madh. E ritheksojmë për panelin shqyrtues se produkti i ofertuar është me i mirë dhe me kualitativ dhe me vlerë me të madhe gjithashtu edhe duke pas parasysh nenin 1 të ligjit të prokurimit që oferta e OE ankues është me e lire .

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron: Fillimisht sqarojmë se OE ankues ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së me datë 28.12.2020 me pretendime të njëjta ankimore sikurse në këtë ankesë. AK me datë 30.12.2020 ka nxjerr vendim me të cilin refuzon kërkesën për rishqyrtim.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke e eliminuar për shkak se ka ofertuar me TV me dimension me të madh se ai i kërkuar në dosjen e tenderit. AK në para masën për pozicionin Smart TV ndër të tjera ka specifikuar kërkesën: "Madhësia e ekranit duhet të jetë 54.6". OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me produktin Toshiba 58UA3A63DG i madhësisë 58". Në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të datës

23.12.2021, AK ka dhënë arsyetimin se OE ankues nuk i plotëson specififikimet teknike për shkak se është kërkuar TV 54.6”, kurse OE ankues ka ofertuar me TV 58”. OE ankues në lidhje me këtë vendim dhe arsyetimin e tij ka dorëzuar kërkesë për rishqyrtim me datë 28.12.2020. AK me datë 30.12.2020 ka nxjerr vendim me të cilin refuzon kërkesën për rishqyrtim. Në arsyetimin e dhënë nga AK për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ndër të tjera AK ka potencuar specifikat e kërkuara janë fikse dhe me qëllim janë detalizuar sepse disa shkolla kane vende specifike për montim të cilat ju përshtaten me disa tabela ekzistuese që do të thotë madhësia e TV nuk guxon të jetë me e madhe siç është para pare andaj nuk mund të pranohet TV me specifika të OE ankues. “Duke marrë për bazë kërkesat e dosjes së tenderit dhe pajisjen e ofertuar nga OE ankues është e qartë se pajisja e ofertuar përmbushë qëllimin dhe specififikimet dhe i tejkalon në kuptimin e madhësisë së ekranit si element që ndikon edhe në çmimin e këtij produkti. Më tej arsyetimi i AK-së nuk është shumë bindës duke marrë për bazë se nuk ka prezantuar asnjë dëshmi konkrete të ndonjë lokacioni ku mund të vendoset TV 54.6” dhe nuk mund të vendoset TV 58”. Po ashtu në rastet kur TV vendoset në mure, panelet e vendosjes janë standarde dhe përfshijnë dimensione që variojnë, shembull nga 50” deri 60”. Andaj, sipas sqarimeve të mësipërme, pretendimi ankimor është i bazuar.

Paneli shqyrtues në bazë të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues , vjen në përfundim se AK nuk ka bërë vlerësimin e drejtë të ofertave në harmoni me nenin 59 të LPP-së, Andaj, obligohet AK që të kërkojë sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t’i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t’i dorëzohet:

- 1x1 AK-“Kuvendit Komunal Gjakovë”
- 1x1 OE-“Aritech” Sh.P.K – Graçanicë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

